



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr.315/8 prot.

Tiranë, 9.8.2022

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 538, datë 7.6.2022 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit znj. Elona Alvora.
- Baza Ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, Neni C, pika 2, Neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese.
- Për dijeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM).
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Të nderuar zonja/zotërinj gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese;

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 25.7.2022 është njoftuar vendimi nr. 538, datë 7.6.2022, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit znj. Elona Alvora, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, Neni F pika 2, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15 ditor nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, Komisioneri Publik ushtron ankim ndaj vendimit nr. 538, datë 7.6.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Elona Alvora prej vitit 2009 e në vijim, ushtron detyrën e prokurorit, aktualisht në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, dhe në zbatim të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Bazuar në nenin Ç, pika 1, të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit për subjektin znj. Elona Alvora ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kriterëve, atë të pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim referuar si Komisioni), ka administruar raportet e vlerësimit për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim referuar si ILDKPKI), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit (në vijim referuar si DSIK) dhe raportin e vlerësimit profesional nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim referuar si KLP), nga të cilat rezulton se:

2.1 ILDKPKI-ja, bazuar në nenin 33, pika 5 të ligjit nr. 84/2016, me anë të “*Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë për subjektin Elona Alvora*”, ka referuar për subjektin, se:

- i. *Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- ii. *Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- iii. *Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- iv. *Nuk ka kryer deklaram të rremë;*
- v. *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

2.2 DSIK-ja, bazuar në nenin 39, pika 2 të ligjit nr. 84/2016, me anë të raportit mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, i ka referuar Komisionit: “*Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës*”.

2.3 KLP-ja, bazuar në nenin 43, pika 2 të ligjit nr. 84/2016, për kontrollin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, znj. Alvora, ka hartuar një raport të hollësishëm, të cilin ia ka përcjellë Komisionit.

3. Përfundimet e Komisionit për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur, janë si vijon:

3.1 **Për vlerësimin e pasurisë.** Referuar nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, Komisioni pasi ka hetuar dhe vlerësuar gjendjen pasurore të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, saktësinë dhe mjaftueshmërinë e deklarimeve periodike të interesave pasurore krahasuar me atë “Vetting”, ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, të ardhurat, shpenzimet dhe pagimin e detyrimeve financiare, ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit: [...] *ka deklaruar saktë pasuritë në deklaratën Vetting dhe nuk janë konstatuar elemente që mund të ngrenë dyshime për fshehje pasurie apo deklarim të rremë. Ndërkohë, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka pasur të ardhura me burime të ligjshme për të mbuluar shpenzimet dhe krijuar likuiditete për të gjithë periudhën e rivlerësimit. Subjekti nuk rezultoi të ketë qenë në kushtet e konfliktit të interesit. [...]*¹.

3.2 **Për kontrollin e figurës.** Referuar nenit DH, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni në konsideratë të verifikimit dhe të konfirmimit nga institucionet përgjegjëse për përshtatshmërinë, edhe pas përditësimit të të dhënave të ardhura nga autoritetet përkatëse ka arritur në përfundimin se, [...] *nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën*

¹ Për më tepër referohuni në f. 13, të vendimit të Komisionit.

e kontakteve të papërshatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirjen e subjektit të rivlerësimit në veprime korruptive [...]².

3.3 Për vlerësimin e aftësive profesionale. Referuar nenit E, të aneksit të Kushtetutës, nenit 43/2 dhe 44 të ligjit nr. 84/2016, si dhe kreut II të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, të ndryshuar, Komisioni pasi ka analizuar raportin e përgatitur nga KLP-ja, hetimit dhe vlerësimit të denoncimeve nga publiku, shpjegimet dhe provat e dhëna nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e barrës së provës për çështjet e dala gjatë hetimit administrativ, si dhe rekomandimin nga ana e relatorit të çështjes, ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit vlerësohet *i aftë*, profesionalisht, për shkak se ka arritur nivelin kualifikues, sipas parashikimit të germës “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

4. Vendimi i Komisionit. Nisur nga përfundimet e mësipërme për secilin kriter kontrolli, trupi gjykues i Komisionit, bazuar në nenin 58, pika 1, germa “a” dhe nenin 59, pikat 1 dhe 4, të ligjit nr. 84/2016, ka vendosur (ndër të tjera si pjesë e dispozitivit):

- Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Elona Alvora, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë;
- Transferimin e procedimeve penale nr. ***/2015 dhe nr. ***/2019 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë në organin kompetent për inspektimin e shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore.

II. Vlerësimi i Komisionerit Publik

5. Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting).

6. Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisioneri Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim referuar si Kolegji).

7. Në krahasim me kompetencat e njohura për Komisionin dhe Kolegjin, nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni.

8. Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave të administruara.

9. Edhe në rastin konkret, Komisioneri Publik mbështetur në kompetencën e tij kushtetuese dhe ligjore, konstaton se nga shqyrtimi i vendimit nr. 538/2022 të Komisionit dhe

² Për më tepër referohuni në f. 15, të vendimit.

akteve shoqëruese të tij, paraqiten rrethana të tilla ligjore e fakti, për të cilat çmon se ky vendim është i cenushtëm në tërësinë e tij, si dhe përmban shkaqe të mjaftueshme ligjore për t'iu paraqitur juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit.

10. Komisioneri Publik, nëpërmjet këtij mjetei procedural (ankimit), synon kontrollin e vendimit nr. 538, datë 7.6.2022, të Komisionit nga ana e Kolegjit, lidhur me nevojën e hetimit të mëtejshëm të kriterit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, bazuar në kërkesat e nenit E të aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, pasi përfundimet e Komisionit për këtë kriter kontrolli ndaj subjektit të rivlerësimit nuk gjejnë mbështetje të plotë në aktet dhe provat e administruara. Duket se në vlerësimin e aftësive profesionale, Komisioni megjithëse ka konstatuar një serë mangësish të së njëjtës natyrë dhe përsëritëse, në përfundim i ka vlerësuar ato jo domethënëse, duke shkëputur nga juridiksioni rivlerësues dy çështje penale, transferuar për inspektim pranë organit kompetent (ILD-së).

11. Sa më sipër, bazuar në kërkesat e dispozitave të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit të posaçëm nr. 84/2016, konstatohet se procesi i hetimit i kryer nga Komisioni nuk ka qenë i plotë e për rrjedhojë, në gjendjen që janë aktet, nuk mund të konkludohet se subjekti i rivlerësimit është në kushtet e parashikuara nga neni 59, pika 1, e ligjit nr. 84/2016.

12. Duke përfunduar, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 4 dhe 66 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik ushtron ankim në tërësi ndaj vendimit nr. 538, datë 7.6.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

III. Analiza e shkaqeve të ankimit

III.A. *Lidhur me nevojën e hetimit të mëtejshëm të gjetjeve për kriterin e aftësive profesionale.*

13. Komisioneri Publik, në analizë të shkaqeve të ankimit, lidhur me nevojën e rivlerësimit dhe hetimit të mëtejshëm të kriterit të aftësive profesionale, mban në konsideratë kufijtë e shqyrtimit brenda kompetencave kushtetuese dhe ligjore të organeve të rivlerësimit, sipas parashikimit të nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 43 e 44 të ligjit nr. 84/2016, në të cilat nuk përfshihet gjykimi apo vlerësimi mbi logjikën apo bazueshmërinë e vendimmarrjes së një magjistrati, në rastin konkret të një prokurori, detyrë dhe kompetencë e organeve më të larta gjyqësore. Në vlerësim janë marrë ato gjetje dhe konstatime të një natyre procedurale, logjike dhe praktike me ndikim në efektivitetin dhe aftësinë e ndjekjes penale, të drejtat procedurale të palëve të prekura, respektimi i afateve dhe i së drejtës për një procedim dhe gjykim të drejtë, respektimi dhe përmbushja e detyrave konkrete të lëna nga gjykata, elementë këto që meritojnë vlerësimin e Kolegjit për sa u përket thelbit të tyre.

14. Për çështjen objekt ankimi, konstatohet se për kontrollin e kriterit të aftësive profesionale, vlerësimi i Komisionit është bazuar në burimet, metodologjinë, periudhën e përcaktuar nga ligji nr. 84/2016, dhe kriteret e parashikuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, konkretisht në: (i) raportin për analizimin e aftësive profesionale, përgatitur nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë; (ii) denoncimet e paraqitura nga publiku; (iii) vlerësimin dhe analizimin e kallëzimeve penale të iniciuara ndaj subjektit të rivlerësimit; (iv) të dhënat arkivore, administruar nga ILD-ja, lidhur me ankesat, masat disiplinore dhe vlerësimet; si dhe informacione të marra nga burime të

hapura, duke administruar dokumentacion, kërkuar shpjegime dhe prova të tjera nga subjekti i rivlerësimit për të kundërtën e barrës së provës.

15. Referuar rezultateve të hetimit administrativ mbi këto akte dhe përfundimeve të arritura nga Komisioni, Komisioneri Publik çmon se hetimi administrativ nuk ka qenë i plotë dhe shterues. Në këtë kontekst, edhe shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit vlerësohen jo bindëse dhe të pamjaftueshme për të rrëzuar barrën e provës, mbi gjetjet e rezultuara nga burimet e administruara, të cilat duhet të merren në shqyrtim dhe të rivlerësohen nga ana e Kolegjit, për rastet si vijon.

16. Kallëzim penal nr. *, viti 2020, procedimi penal me nr. ***, i vitit 2021.**

16.1 Referuar denoncimit të shtetasit *** ** të datës **.7.2022 (në cilësinë e administratorit të shoqërisë “**** **., sh.p.k.”), të dhënave të dala nga përmbajtja dhe dokumentacioni shoqëruar i *denoncimit*, pretendohet se subjekti i rivlerësimit ka zvarritur me qëllim hetimin për kallëzimin penal të vitit 2020, edhe pse ka vendime gjyqësore që e detyrojnë të bëjë regjistrimin e procedimit penal dhe kryerjen e veprimeve hetimore. Objekt i kallëzimit penal është për *kundërvajtjen penale* “Shkelja e të drejtave të pronësisë industriale” të parashikuar nga neni 149/a i Kodit Penal, ku parashikohet dënimi me gjobë dhe marzhi maksimal me burgim gjer në dy vjet.

16.2 Komisioni në “*Rezultatet e hetimit kryesisht subjektit të rivlerësimit Elona Alvora*”, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të jap shpjegime lidhur me konstatimet: (i) Për veprime dhe mosveprime individuale të cilat kanë ndikuar në zvarritjen e hetimit të çështjes; (ii) Sjellja profesionale e subjektit duket me mangësi, pasi subjekti nuk kryen menjëherë verifikime të mundshme kur është e nevojshme, por vetëm nëse, mbi veprimet hetimore të procedimeve të hetuara shprehet gjykata, dhe urdhërohet për kryerjen e tyre nga gjykata. Subjekti znj.Alvora iu përgjigj këtyre çështjeve më datë 29.4.2022.

16.3 Komisioni në arsyetimin e vendimit nr. 538/2022³, ku ka disponuar konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, përshkruan se ka analizuar dhjetë denoncime, midis tyre edhe atë të z. *** **., dhe është ndalur vetëm në dy prej tyre, atë të shtetasit *** ** dhe *** **, duke mos dalë në përfundim të shprehur lidhur me denoncimin e shtetasit *** **.

16.4 Nga shqyrtimi i akteve në dosje të Komisionit, rezulton:

- Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë (në vijim referuar Prokuroria Vlorë) më datë **.7.2020, është regjistruar materiali kallëzim nga shtetasi *** **⁴, dhe pas pranimit të heqjes dorë të prokurorit *** **., me shortin manual të datës **.7.2020, është ngarkuar për vazhdimin e hetimeve subjekti znj. Alvora. Në datë **.9.2020, subjekti znj. Alvora ka marrë vendimin “Për mosfillimin e procedimit penal”, referuar kallëzimit penal nr. ***, të vitit 2020, i ankimuar nga shtetasi *** **.

- Me vendimin nr. ***, datë **.12.2020, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, ka vendosur pranimin e ankimit, shfuqizimin e vendimit “Për mosfillimin e procedimit penal”, datë **.9.2020 të Prokurorisë Vlorë, duke urdhëruar kryerjen e veprimeve hetimore të përcaktuara

³ Referohuni f. 18, të vendimit.

⁴ Referuar f. 4, të vendimit gjyqësor, rezulton se i vëllai *** ** është administrator i shoqërisë *** **., sh.p.k., e cila ka markë të mbrojtur instekticidin me logon “H10”.

në pjesën arsyetuese të vendimit. Ndër të tjera, gjykata ka arsyetuar: (i) “Në funksion të hetimit të plotë të çështjes është i nevojshëm të merret informacion nga Drejtoria e Markave dhe Patentave nëse produkti i tregëtuar nga kompanitë e kallëzuara është markë e mbrojtur dhe nëse po të përcaktohet se cila është shoqëria që e ka mbrojtur atë. (ii) Prokuroria ka bërë interpretim të gabuar lidhur me elementin “pronari ka dhënë pëlqimin” parashikuar në nenin 149/a/1 të Kodit Penal. Gjukata çmon se elementi dhënie pëlqimi i referohet një akordi të arritur me qëllim importimin për arsye tregtimi. Kështu prokuroria për të konkluduar lidhur me pëlqimin duhet të hetoj në këtë drejtim.” Pas ankimit të subjektit të rivlerësimit ndaj këtij vendimi, Gjukata e Apelit me vendimin nr. **, datë **.3.2021, ka vendosur mospranimin e ankimit, pas heqjes dorë nga prokurori i apelit.

- Subjekti i rivlerësimit më datë **.1.2022, ka nxjerrë aktin urdhër “Për regjistrimin e procedimit penal”, në zbatim të vendimit gjyqësor nr. ***, datë **.12.2020, të Gjukatës së Shkallës së Parë Vlorë (i formës së prerë).

- Gjithashtu nga përmbajtja e vendimit të Gjukatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me nr. *** datë **.10.2021, rezulton se për të njëjtën vepër penale ka paraqitur kallëzim edhe shtetasi *** ***, më datë **.5.2021, me cilësinë e administratorit të shoqërisë “**** sh.p.k.” kundër shoqërisë “****” sh.p.k.. Subjekti i rivlerësimit më datë **.6.2021, ka marrë vendimin “Për mosfillimin e procedimit penal që i përket kallëzimit nr. ***, të vitit 2021. Ankuesi *** ***, ka depozituar ankim kundër këtij vendimi të cilin Gjukata e ka pranuar dhe ka urdhëruar kryerjen e veprimeve hetimore të përcaktuara në pjesën arsyetuese të vendimit⁵. Prokuroria Vlorë ka ushtruar ankim në Gjukatën e Apelit Vlorë.

16.5 Komisioneri Publik, sa më lart referuar, vlerëson se del e nevojshëm të hetohet, në drejtim të verifikimit nëse veprimet e ndërmarra nga subjekti i rivlerësimit në këtë procedim penal, të filluar në muajin korrik 2020 deri aktualisht⁶, janë në përmbushje të standardeve të nenit 73, pika 2 të ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar, përsa i përket aftësisë për të hetuar, për të marrë urdhra dhe vendime. Gjithashtu, referuar gjendjes së akteve në dosje të Komisionit, të cilat janë ato të paraqitura nga denoncuesi apo vetë subjekti i rivlerësimit, vërehen afate kohore të pajustificueshme në drejtim të zbatimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, si dhe *prima facia*, këto vonesa, për shkak të llojit të veprës penale *kundërvajtje penale*, çojnë në parashkrimin e ndjekjes penale.

⁵ Referohuni në f. 4, të vendimit ku veçojmë: “Nga analiza e të gjitha rrethanave dhe fakteve që u vërtetuan në gjykim, gjykata çmon se arsyetimi i prokurorit se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale është i gabuar dhe në kundërshtim me ligjin. Që prokuroria të arrinte në këtë përfundim pa filluar çështja penale, për pasojë pa kryer hetime që lidhen me sa i referohet, duhej të konstatonte që fakti i kallëzuar nuk parashikohet si vepër penale nga Kodi Penal, ose ligje të tjera që parashikojnë vepër penale. Prokuroria nuk ka qenë para faktit që fakti i kallëzuar nuk parashikohet nga ligji si vepër penale, asaj i është kallëzuar për një vepër e cila parashikohet si vepër nga Kodi Penal që është “shkelja e të drejtave të pronësisë industriale”, e parashikuar nga neni 149/a i Kodit penal. Nëse fakti ekziston ose jo, dhe nëse vepra është kryer nga personi i kallëzuar, ky përfundim mund të nxirret, vetëm pasi të jenë kryer hetime lidhur me rrethanat. Pra, organi procedues që të kryejë veprime hetimore, mosmiratimin e kërkesës dhe kthimin e akteve prokurorit për vazhdimin e hetimeve, detyrimisht duhet të fillojë çështjen penale dhe të kryejë verifikimet përkatëse. Prokuroria duhet të kishte zhvilluar hetime, të kishte verifikuar, nëse produkti është markë e mbrojtur duke marrë informacion nga Drejtoria e Markave dhe Patentave, nëse produkti i tregëtuar nga shoqëria e kallëzuar është markë e mbrojtur dhe nëse po, të përcaktohet se cila është shoqëria që e ka mbrojtur atë. Gjukata çmon se Prokuroria ka bërë interpretim të gabuar lidhur me elementin “pronari ka dhënë pëlqimin” parashikuar në nenin 149/a/1 të Kodit Penal. Gjukata çmon se, elementi dhënie pëlqimi i referohet një akordi të arritur me qëllim importimin për arsye tregtimi. Kështu, Prokuroria për të konkluduar lidhur me pëlqimin duhet të hetojë në këtë drejtim. Vetëm, pasi të kryente këto veprime hetimore apo veprime të tjera që mund të lindin të nevojshme pas kryerjes së tyre, në raport me rezultatin e këtyre hetimeve do të mund të vendoste, nëse çështja duhet të referohet gjykatës për tu gjykuar, apo duhet pushuar për një nga shkaqet që parashikohen në ligj.

⁶ Referuar përgjigjeve të subjektit të rivlerësimit datë 29.4.2022, statusi i çështjes është në proces hetimi.

17. *Procedimi penal me nr. ***, i vitit 2017.*

17.1 Referuar denoncimit të shtetasit *** ** të datës **. 9.2018 (depozituar në Komision), dhe datës **.10.2020 (depozituar në Inspektoriatin e Lartë të Drejtësisë), të dhënave të dala nga përmbajtja dhe dokumentacioni shoqërues i *denoncimeve*, pretendohet se subjekti i rivlerësimit ka zvarritur hetimin për kallëzimin penal të vitit 2017, nuk e ka informuar kallëzuesin e veprës penale që nga data **.8.2017, viktimën e veprës penale në kuptim të nenit 58/dh të Kodit të Procedurës Penale. Objekt i kallëzimit penal është për veprën penale “*Ndërtim i paligjshëm*” parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal, ku parashikohet dënimi me gjobë dhe marzhi maksimal me burgim deri në tetë vjet, dhe për *kundërvajtjen penale* “*Pushtim i tokës*”, parashikuar nga neni 200 i Kodit Penal, ku parashikohet dënimi me gjobë ose burgim deri në dy vjet.

17.2 Komisioni në “*Rezultatet e hetimit kryesisht subjektit të rivlerësimit Elona Alvora*”, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të jap shpjegime lidhur me konstatimet⁷: (i) Për zvarritje të hetimeve pa shkaqe të motivuara; (ii) Për moskryerje të hetimeve të plota në mënyrë të pamotivuar dhe për moskryerjen menjëherë të verifikimeve të mundshme dhe të nevojshme në zbatim të detyrimit ligjor si prokurore e çështjes. Subjekti, znj. Alvora iu përgjigj këtyre çështjeve më datë 29.4.2022⁸.

17.3 Komisioni në arsyetimin e vendimit nr. 538/2022, përshkruan se ka analizuar dhjetë denoncime midis tyre edhe atë të z. ***, dhe është ndalur vetëm në dy prej tyre, atë të shtetasit *** ** dhe *** **, duke mos dalë në përfundim të shprehur lidhur me këtë denoncim⁹.

17.4 Nga shqyrtimi i akteve në dosje të Komisionit, rezulton se:

- Prokuroria Vlorë, mbi bazën e materialit kallëzues të referuar nga Komisariati i Policisë Vlorë, ka vendosur regjistrimin e kallëzimit penal nr. *** të vitit 2017, ku është ngarkuar për vazhdimin e hetimeve subjekti, znj. Alvora. Subjekti i rivlerësimit ka marrë vendimin “Për mosfillimin e procedimit penal”, për kallëzimin penal nr. ***, të vitit 2017, vendimi i ankimuar nga shtetasi *** **.

- Me vendimin nr. ***, datë **.12.2017, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, ka vendosur pranimin e ankimit, shfuqizimin e vendimit “Për mosfillimin e procedimit penal nr. *** të vitit 2017 të Prokurorisë Vlorë, duke urdhëruar regjistrimin e procedimit penal për veprën penale të “Ndërtimit të paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal duke urdhëruar kryerjen e të gjitha veprimeve të nevojshme hetimore të parashikuara në pjesën përshkruese-arsyetuese të këtij vendimi. Ndër të tjera, gjykata ka arsyetuar lidhur me veprimet e organit të akuzës: (i) “... duhet të ishin pyetur në cilësinë e personave që kanë patur dijeni për veprën penale shtetasit *** **, punonjësit e IMT-së Bashkia Himarë, shtetasit *** ** dhe *** ** (të cilët rezultojnë të kenë përpiluar procesverbalin nr. **, datë **.7.2017 “Për konstatimin e kundërvajtjes administrative” si dhe personat e tjerë, që mund të identifikohen në varësi të hetimit, që mund të tregojnë rrethana të nevojshme për hetimin. (ii) ... duhet të ishte proceduar me kryerjen e vendit të ngjarjes ... me qëllim sqarimin e fakteve dhe rrethanave objekt kallëzimi ... (iii) ... duhet të ishte kryer një akt ekspertimi topografik sipas nenit 178 të K. Pr. Penale...

⁷ Referohuni f. 58, të *Rezultateve të hetimit kryesisht*.

⁸ Referohuni f. 22, të përgjigjeve të subjektit të datës 29.4.2022.

⁹ Referohuni f. 18, të vendimit.

(iv) ... duhet të ishte procedura me sekuestrimin dhe më pas kqyrjen e të gjithë praktikës administrative të ndjekur nga IMT-ja Bashkia Himarë.... Gjykata vlerëson se vetëm pas kryerjes së veprimeve të sipërcituara hetimore organi i akuzës do të jetë në gjendje të arrijë një përfundim më të drejtë dhe objektiv, në lidhje me faktin nëse ndodhemi përpara veprave penale të kallëzuar nga shtetasi *** dhe nëse po, në lidhje me kualifikimin juridik të faktit penal, si dhe individualizimin e autorit apo autorëve të tij, duke i paraqitur në çdo rast, kërkesë gjykatës për pushimin e çështjes ose dërgimin e saj në gjykim...”. Pas ankimit të Prokurorisë Vlorë, Gjykata e Apelit me vendimin nr. ***, datë **.2.2018 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit gjyqësor penal nr. ***, datë **.12.2017, të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë.

17.5 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigjet e datës 29.4.2022¹⁰, shprehet se *ky procedim nuk ka ende një vendimarrje përfundimtare, pra vijon të jetë në fazën e hetimit paraprak. Vendimi i pezullimit tregon se janë ezauruar mundësitë e momentit për të kryer veprime hetimore dhe se do të duhet të angazhohen strukturat e rendit me qëllim hapjen e dosjeve policore për të vijuar me grumbullimin e informacionit të mëtejshëm që mund të diktojnë kryerjen e veprimeve hetimore të reja apo të veprimeve hetimore që kanë qënë objektivisht të pamundura kur është pezulluar çështja.*

17.6 Komisioneri Publik, sa më lart referuar, vlerëson se del e nevojshme të hetohet, në drejtim të verifikimit, nëse veprimet e ndërmarra nga subjekti i rivlerësimit në këtë çështje penale, të filluar në muajin korrik 2017 deri aktualisht¹¹, janë në përmbushje të standardeve të nenit 73, pika 2 të ligjit 96/2016, i ndryshuar, përsa i përket aftësisë për të hetuar, për të marrë urdhra dhe vendime. Gjithashtu, vërehen afate kohore të pajustificueshme në drejtim të zbatimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, si dhe mënyrës së zbatimit të nenit 326 “Pezullimi i hetimeve” të Kodit të Procedurës Penale.

18. Procedimi penal me nr. *, i vitit 2017.**

18.1 Referuar denoncimit të shtetasit *** të datës **.1.2021 (depozituar në Inspektoriatin e Lartë të Drejtësisë, përcjellë në Komision), të dhënave të dala nga përmbajtja dhe dokumentacioni shoqërues i tij, pretendohet se subjekti i rivlerësimit ka favorizuar personat e kallëzuar, duke mos hetuar në drejtim të hetimit për falsitetin e dokumentit, objekt kallëzimi të deklaruar me vendimin gjyqësor, si dhe prej muajit qershor 2020 kur Gjykata e Apelit Vlorë ka urdhëruar vazhdimin e hetimeve, brenda afatit 3 mujor, subjekti znj. Alvora nuk ka kryer asnjë veprim procedural për zbatimin e vendimit dhe të detyrave të lëna për vazhdimin e hetimeve. Objekt i kallëzimit penal është për krimin “Falsifikimi i dokumentave” të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, ku parashikohet dënimi me burgim, marzhi maksimal deri në katër vjet.

18.2 Komisioni në “Rezultatet e hetimit kryesisht subjektit të rivlerësimit Elona Alvora”, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të jap shpjegime lidhur me konstatimet¹²: (i) Se deri më datë **.3.2022 nuk kanë përfunduar hetimet shtesë të urdhëruara nga Gjykata e Apelit dhe të vetmin veprim hetimor të kryer është ai i datës **.12.2020 “Urdhër për rifillimin e hetimit

¹⁰ Referohuni në f. 22, të këtij akti.

¹¹ Referuar përgjigjeve të subjektit të rivlerësimit datë 29.4.2022, f. 22, statusi i çështjes është “vijon të jetë në fazën e hetimit paraprak”.

¹² Referohuni f. 46, të Rezultateve të hetimit kryesisht.

paraprak...”, (ii) Për moskryerje në kohë të veprimeve të nevojshme hetimore duke zvarritur hetimet. Subjekti, znj. Alvora iu përgjigj këtyre çështjeve më datë 29.4.2022¹³.

18.3 Komisioni në arsyetimin e vendimit nr. 538/2022, lidhur me ankesat me burim Prokurorinë e Përgjithshme dhe Inspektoriatin e Lartë të Drejtësisë, midis tyre edhe atë të z. *** ***, ka arritur në përfundimin se, *mangësitë e konstatuara janë të pashoqëruara me mangësi të tjera dhe në raport me ngarkesën e çështjeve të hetuara nuk janë të mjaftueshme për ti çmuar si cilësi të papranueshme në punë, gjykim të dobët apo një mënyrë pune e papajtueshme me funksionin e saj¹⁴.*

18.4 Nga shqyrtimi i akteve në dosje të Komisionit, rezulton se:

- Subjekti, znj. Alvora në cilësinë e prokurores së çështjes, me vendimin “Për bashkimin e procedimeve”, datë **.12.2017, ka vendosur të bashkojë dy procedime penale në një të vetëm me **nr. *** të vitit 2017**, për hetimin e veprës penale të “Falsifikimit të dokumentave” të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, konkretisht, (i) procedimin penal nr. *** të vitit 2017, të filluar mbi bazën e vendimit civil të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, datë **.10.2017¹⁵, dhe (ii) procedimin penal nr. ***, të vitit 2017, të filluar mbi bazën e kallëzimit penal nga shtetasi *** ***,
- Më datë **.12.2019, subjekti znj. Alvora, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë me kërkesën për pushimin e procedimit penal **nr. *** të vitit 2017** dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë me vendimin nr. ***, datë **.3.2020, ka vendosur pushimin e procedimit penal, vendim ky i ankimuar nga shtetasi *** ***,
- Me vendimin nr. ***, datë **.6.2020, Gjykata e Apelit Vlorë ka vendosur, *ndryshimin e vendimit ***, datë **.3.2020 të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë dhe dërgimin e akteve në prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë për vazhdimin e hetimeve brenda një afati 3 muaj sipas detyrave në pjesën arsyetuese të këtij vendimi.* Gjykata, ndër të tjera, ka arsyetuar sa vijon: (i) Organi i akuzës nuk ka bërë të gjitha veprimet e nevojshme hetimore, dhe në përfundim ka arritur në konkluzion të gabuar për pushimin e çështjes penale, për shkak se nuk provohet që vepra penale është kryer nga trashëgimtarët e të ndjerit *** ***, (ii) Pretendimet e kallëzuesit në lidhje me deklaratimet e dhëna nga shtetasi *** *** dhe *** *** nuk janë hetuar dhe nuk janë analizuar në vendimin e saj për pushimin e procedimit penal; (iii) Në lidhje me regjistrat e dorëzuar në Bashki, Prokuroria është mjaftuar vetëm me deklaratimet e dhëna nga shtetasi *** *** ... pa marrë në analizë e pahetuar më thellë në lidhje me deklaratimet e bëra nga titullari i Arkivit, i cili ka deklaruar, se për shkak të ndërhyrjeve të bëra në dokument, punonjësi që adminstronte “Librin Themeltar të Pasurive të Paluajtshme” është arrestuar dhe këto regjistra janë tërhequr në Tiranë; (iv) Nuk është hetuar, as në lidhje me faktin, se përse në të gjitha proceset gjyqësore ku kanë qënë palë trashëgimtarët e të ndjerit *** ***, janë përdorur si dokumenta për të vërtetuar pronësinë dokumenti “Libri Themeltar i Pasurive të Paluajtshme” dhe jo Vendimi nr. 8, datë 23.1.1953, i Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të Rrethit Vlorë, i cili gjendej në Fondin Arkivor të Republikës së Shqipërisë; (v) Organi i akuzës duhej të orientojë hetimin e saj në kryerjen të gjitha veprimeve të nevojshme hetimore për të

¹³ Referohuni f. 14-15, të përgjigjeve të subjektit të datës 29.4.2022.

¹⁴ Referohuni f. 18, të vendimit.

¹⁵ Vendimi civil nr. ***, datë **.10.2017, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në pikën 2 deklaroi *falsitetin e aktit të titulluar “Libri themeltar i pasurisë së paluajtshme “ku citohen të dhëna në lidhje me Vendimin nr.8, datë 23.1.1953 të Komitetit Ekzekutiv për dhënie pasurie shtetasit *** ***.”*

konstatuar dijeninë ose jo të trashëgimtarëve të të ndjerit *** *** të falsitetit të dokumentit të përdorur prej tyre, i cili ka shërbyer për njohjen gjyqësisht të së drejtës së pronësisë mbi tokën e pretenduar, si dhe të hetojë mbi subjektin që ka ndërhyrë në dokumentin në fjalë.

- Më datë **.12.2020, subjekti i rivlerësimi ka nxjerrë urdhërin “Për rifillimin e hetimit paraprak” të procedimit penal nr. *** të vitit 2017, për hetimin e veprës penale të “Falsifikimit të dokumentave” me qëllim kryerjen e veprimeve hetimore të urdhëruara me vendim gjyqësor nr. *** datë **.6.2020 të Gjykatës së Apelit Vlorë.

18.5 Subjekti i rivlerësimit në përgjigjet e datës 29.4.2022¹⁶, shprehet se ky procedim është ende në proces dhe se nuk po gjendet dokumenti origjinal me qëllim të bëhet ekspertimi i tij për falsitet të plotë apo të pjesshëm, si dhe përshkruan administrimin dhe përmbajtjen e dokumentacionit para datës **.6.2020, kur është marrë vendimi i Gjykatës së Apelit Vlorë, si dhe referon prishjen e vendimit civil të datës **.10.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, nga Gjykata e Apelit Vlorë (pa e paraqitur atë apo referenca të përmbajtjes së tij). Gjithashtu lidhur me afatin kohor 3 muaj të lënë nga Gjykata e Apelit Vlorë, subjekti shprehet se, në rastin e procedimeve penale pa autor, këto afate konsiderohen sugjeruese. Vërejmë se logjika e përdorur nga subjekti, znj. Alvora në shpjegimet e saja të datës 22.4.2022, nuk rezulton të jenë materializuar në akte procedurale, qoftë për rastin e mosnjohjes së autorit të veprës penale, parashkrimit të ndjekjes penale apo për rënien e faktit penal, për shkak të vendimit civil të Gjykatës së Apelit Vlorë.

18.6 Komisioneri Publik, sa më lart referuar, vlerëson se del e nevojshme të hetohet, në drejtim të verifikimit, nëse veprimet e ndërmarra nga subjekti i rivlerësimit në këtë çështje penale të filluar në muajin dhjetor 2017 deri aktualisht¹⁷, janë në përmbushje të standardeve të nenit 73, pika 2 të ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar, për sa i përket aftësisë për të hetuar, për të marrë urdhra dhe vendime. Gjithashtu, vërehen afate kohore të pajustificueshme në drejtim të zbatimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

19. Procedimi penal me nr. * i vitit 2015.**

19.1 Referuar denoncimit të shtetasës *** *** (përfaqësuese e të atit z. *** ***) të datës **.11.2019, depozituar në Komision, të dhënave të dala nga përmbajtja dhe dokumentacioni shoqëruar i tij, pretendohet ndër të tjera, se subjekti i rivlerësimit, ka kryer hetime të paplota dhe tendencioze, pasi nuk merret me thelbin e problemit të certifikuar edhe nga Gjykatat, se segmenti rrugor i cili ka dëmtuar pronën e denoncueses është një ndërtim pa leje, por me rrethana të tjera që kanë të bëjnë me investimet në zonë. Objekt i kallëzimit penal paraqet rrethana që lidhen me veprën penale “Ndërtim i paligjshëm” të parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal, ku parashikohet dënimi me burgim, marzhi maksimal deri në pesë vjet dhe me kundërvajtjen penale “Pushtimi i tokës”, parashikuar nga neni 200 i Kodit Penal.

19.2 Komisioni në “Rezultatet e hetimit kryesisht subjektit të rivlerësimit Elona Alvora”, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të jap shpjegime lidhur me konstatimet se¹⁸: (i) Veprimet dhe mosveprimet individuale të subjektit të rivlerësimit kanë ndikuar në zvarritjen e pajustificuar të çështjes në kuptim të nenit 304 të Kodit të Procedurës Penale; (ii) Subjekti i rivlerësimit

¹⁶ Referohuni në f. 14-15, të aktit.

¹⁷ Referuar përgjigjeve të subjektit të rivlerësimit datë 29.4.2022, f. 14, kjo çështje është ende në proces.

¹⁸ Referohuni në f. 51, 52 dhe 54, të aktit.

është sërish përsëritës në moskryerjen e hetimeve të plota në kuptim të nenit 329 “ç”¹⁹ të K.Pr.Penale, pasi edhe pas urdhërimeve nga Gjykata e Apelit, dy herë, nuk i ka dhënë zgjidhje procedimeve për periudha të gjata kohore, ka vonuar nxjerrjen e rezultateve të hetimit në mënyrë të pamotivuar, pasi nuk ka kryer menjëherë verifikime të mundshme kur ishte e nevojshme; (iii) Zbatimin e udhëzimit nr. 8, datë 4.12.2019 të Prokurorit të Përgjithshëm, lidhur me zbatimin e pikës 3, të nenit 4, kreu II, pikës 4 të nenit 15, si dhe ankimit ndaj vendimit kur gjykata vendos pafajësi; (iv) Heqjes dorë nga hetimi i mëtejshëm i çështjes me nr. *** viti 2015, patur parasysh regjistrimin e procedimit penal nr. ***/2019 nga SPAK, regjistruar pa emra personash që iu atribuohet vepra penale; (v) Cënimit të ecurisë së procesit gjyqësor pa shkaqe të arsyeshme, në seancën gjyësore të datës **.6.2020, duke konsumuar shkelje të etikës së prokurorit dhe aftësi profesionale jo të mira, referuar nenit 75 dhe 76 të ligjit nr. 96/2016. Subjekti znj. Alvora iu përgjigj këtyre çështjeve më datë 29.4.2022²⁰.

19.3 Komisioni në arsyetimin e vendimit nr. 538/2022, përshkruan se ka analizuar dhjetë denoncime, midis tyre edhe atë të znj. *** ***, dhe është ndalur vetëm në dy prej tyre, atë të shtetasit *** *** dhe *** *** duke mos dalë në përfundim të shprehur lidhur me këtë denoncim²¹.

19.4 Nga shqyrtimi i akteve në dosje të Komisionit, rezulton:

- Më datë **.7.2015, subjekti znj. Alvora në cilësinë e prokurores së çështjes, mbi bazën e kallëzimit penal të datës **.7.2015, të shtetasës *** ***, ka nxjerrë urdhërin për regjistrimin e procedimit penal nr. *** për veprën penale “Pushtimi i tokës” parashikuar nga neni 200 i Kodit Penal.

- Më datë **.9.2015, subjekti ka nxjerrë urdhërin “Për kryerjen e veprimeve hetimore” me afat data **.10.2015, dhe janë mbajtur procesverbalet për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale në datat **.9.2015, **.2.2016 dhe **.5.2016.

- Më datë **.5.2016, subjekti ka marrë vendimin “Për pushimin e procedimit penal nr. ***, viti 2015, vendim i ankimuar në Gjykatë.

- Më datë **.6.2017 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. ***, ka vendosur pranimin e kërkesës së ankuesit *** ***, shfuqizimin e vendimit datë **.5.2016 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, urdhërimin e Prokurorisë Vlorë të vazhdoj hetimet për procedimin penal nr. ***, të vitit 2015. Ky vendim është ankimuar nga Prokuroria Vlorë dhe është lënë në fuqi me vendimin nr. ***, datë **.11.2017, të Gjykatës së Apelit Vlorë.

- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, ndër të tjera, me vendimin nr. ***, datë **.6.2016, ka arsyetuar sa vijon: (i) Nga ana e Prokurorisë nuk janë kryer hetime të plota, të gjithanshme në përputhje me ligjin dhe se gjatë hetimeve paraprake prokurori nuk ka kryer të gjitha veprimet hetimore të nevojshme për sqarimin e çështjes; (ii) Pavarësisht se ka ardhur në dijeni gjatë hetimeve, për punime ndërtimi në pronën e z. *** *** nga ana e shoqërisë “****” sh.p.k., në kundërshtim me projektin e miratuar nga Autoriteti Rrugor Shqiptar (në vijim ARrSh), nuk ka hetuar lidhur me këtë fakt; (iii) Nuk ka kryer një akt ekspertimi me qëllim që të përcaktonte volumin e punimeve të kryera, llojin e punimeve, nëse punimet e kryera nga shoqëria “****” sh.p.k., konsiderohen ndërtime; (iv) Nëse punimet janë kryer në përputhje me projektin e

¹⁹ Lapsus është neni 332/ç “Vendimi për plotësimin e hetimeve”.

²⁰ Referohuni në f. 16-22, të përgjigjeve të subjektit të datës 29.4.2022.

²¹ Referohuni në f. 18, të vendimit.

miratuar nga ARrSh; (v) Prokuroria është bazuar në arritjen e konkluzioneve të saj, duke u mbështetur vetëm në dokumentacionin e dorëzuar nga kallëzuesja gjatë hetimit, ndërsa nuk ka kryer verifikim të këtij dokumentacioni – nuk ka kërkuar dokumentacion pronësie në ZVRRP Vlorë, - nuk ka kërkuar projektin e rrugës në ARrSh, - nuk ka kërkuar kontratën nr. ***/**, datë **.7.2009, nënshkruar nga bashkimi i operatorëve “****” sh.p.k..., - nuk ka kërkuar vendimin e marrë nga mbledhja e Këshillit Teknik të ARrSh e datës **.1.2013, ku është marrë në shqyrtim propozimi për shtesë kontrate dhe është ndryshuar projekti; (vi) Pavarësisht përcaktimit juridik që i ka dhënë kallëzuesi faktit penal të kallëzuar prej tij, Prokuroria është e detyruar që ti jap këtij fakti cilësimin e duhur juridik. Gjykata çmon se ekzistenca apo jo e veprave penale të parashikuara nga nenet 199/a, 199/b apo 150 të Kodit Penal rezulton vetëm pas kryerjes së të gjitha veprimeve hetimore të përmendura më lart apo edhe të tjera që mund të rezultojnë të nevojshme pas kryerjes së tyre. Vetëm pas kryerjes së tyre mund të arrihet në një konkluzion të drejtë dhe të bazuar për mënyrën e përfundimit të procedimit penal.

- Më datë **.2.2018, subjekti i rivlerësimit ka nxjerrë urdhërin “Për rifillimin e hetimeve të procedimit penal nr. *** të vitit 2015”

- Më datë **.11.2018, subjekti znj. Alvora i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë me kërkesën për pushimin e procedimit penal nr. ***, të vitit 2015 me objekt hetimi veprën penale të “Pushimit të tokës” të parashikuar nga neni 200 i Kodit Penal.

- Më datë **.3.2019, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë me vendimin nr. ***, ka vendosur rrezimin e kërkesës për pushimin e procedimit penal nr. ***, të vitit 2018²², kthimin e akteve prokurores znj. Elona Alvora, duke urdhëruar kryerjen e këtyre veprimeve procedurale: (i) Regjistrimin në regjistrin e veprave penale të emrit të personit juridik “****” sh.p.k., në cilësinë e personit që i atribuohet vepra penale; (ii) Formulimin e akuzës dhe marrjen si të pandehur të personit juridik “****” sh.p.k., për veprën penale të “Ndërtimit të paligjshëm në tokë të tjetrit”, parashikuar nga neni 199/a/2 i Kodit Penal; (iii) Paraqitjen pranë gjyqtarit të seancës paraprake të kërkesës për dërgimin në gjyq të procedimit penal nr. ***, të viti 2018, sipas urdhërimit të Gjykatës. Ky vendim ka marrë formë të prerë, pasi është lënë në fuqi nga vendimi i Gjykatës së Apelit Vlorë me nr. *** datë **.6.2019, pas ankimit nga Prokuroria Vlorë.

- Më datë **.10.2019, subjekti i rivlerësimit ka nxjerrë urdhërin “Për rifillimin e hetimit të procedimit penal nr. ***, të vitit 2015... duke zgjeruar objektin e hetimit të procedimit penal dhe urdhëruar regjistrimin e veprës penale “Ndërtim të paligjshëm” të parashikuar nga neni 199/a/2 i Kodit Penal, shënimin e emrit të personit që i atribuohet vepra penale, shoqërisë tregtare “****” sh.p.k., dhe emrin *** ***.

- Më datë **.11.2019, subjekti znj. Alvora ka marrë vendimin për marrjen si të pandehur dhe njoftimin e akuzës për shoqërinë tregtare “****” sh.p.k., dhe *** *** dhe po në datë **.11.2019, ka nxjerrë urdhërin për kryerjen e veprimeve hetimore për t’i komunikuar akuzën të pandehurve.

- Më datë **.11.2019, është mbajtur proces verbali i pyetjes së pandehurit *** ***, gjithsej 1 fletë.

²² Vërejmë se objekti në vendimin gjyqësor referon edhe veprat penale “Ndërtim i paligjshëm”, “Dhënies së ndihmës për ndërtim të paligjshëm” dhe “Shkatërrim të pronës” që nuk evidentohen në kërkesë për pushimin e çështjes, adminstruar në dosje të KPK-së.

- Më datë **.12.2019, subjekti znj. Alvora ka marrë vendimin “Për pushimin e pjeshëm të çështjes, përse i përket objektit të hetimit të veprës penale “Pushtimi i tokës”, parashikuar nga neni 200 i Kodit Penal.

- Më datë **.12.2019, subjekti i rivlerësimit i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë me kërkesën për gjykimin e procedimit penal nr. ***, të vitit 2015, me të pandehur, Florenc Gjiguria, akuzuar për kryerje të veprës penale të “Ndërtimit të paligjshëm në tokë të tjetrit”, të parashikuar nga neni 199/a/2 i Kodit Penal dhe shoqëria tregtare “****” sh.p.k., akuzuar për kryerjen e veprës penale të “Ndërtimit të paligjshëm në tokë të tjetrit”, parashikuar nga neni 199/a/2 i Kodit Penal.

- Në gjykimin e çështjes në Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar përjashtimin nga gjykimi të gjyqtarit *** ***, kërkesë kjo e rrëzuar me vendimn e datës **.6.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe pas rekursit në Gjykatë të Lartë, Kolegji Penal me vendimin e datës **.9.2020, ka vendosur mospranimin e rekursit.

- Më datë **.5.2021, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë²³, me vendimin nr. ***, ka vendosur të deklarojë të pafajshëm të pandehurin *** *** dhe shoqërinë “****” sh.p.k.. Ky vendim ka marrë formë të prerë më datë **.8.2021, pasi nuk është ankimuar nga Prokuroria Vlorë.

- Gjithashtu, vërehet se në dosje të Komisionit, janë adminstruar edhe dy vendime gjyqësore të gjykatave me juridiksion të posaçëm, që lidhen me materialin e kallëzimit penal nr. ***, viti 2018, paraqitur në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda nga shtetasja *** ***, për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës” dhe “Grupit të strukturuar kriminal”, të lidhura me procedimin penal nr. ***, viti 2015, të hetuar në Prokurorinë e pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për të cilin është vendosur regjistrimi i procedimit penal, por pa autor.

19.5 Subjekti i rivlerësimit në përgjigjet e datës 29.4.2022²⁴, shprehet se: (i) Nuk ka patur arsye për të hequr dorë dhe se kërkesa për zëvendësimin e saj si prokurore e çështjes është rrëzuar me vendimin e datës **.10.2019; (ii) Për kohëzgjatjen e procesit subjekti referon si model gjyqtarin e themelit, i cili do të vendos në fund, nëse akuza e ngritur është e bazuar (fajësi) apo jo dhe se prokurorit i faturohen edhe kohëzgjatja e qëndrimit të çështjes në gjykatë apo në sekretarinë gjyqësore; (iii) Për mosankimin e vendimit të pafajësisë shprehet se urdhëri i Prokurorit të Përgjithshëm të datës 4.12.2019, i është pezulluar efekti për shkak se Prokurori i ri i Përgjithshëm , i cili ka marrë detyrën në datë 5.12.2019, ka vendosur rishkimin dhe më pas në vitin 2020 ka nxjerrë një udhëzim të ri, si dhe shprehet se në lidhje me ankimin e vendimit të pafajësisë në praktikë ka disa kushte kur nuk pritet që prokurorët e çështjes të ankimojnë vendimin²⁵; (iv) Lidhur me zbatimin e dispozitave për “kërkesën për gjykim” subjekti znj. Alvora hap një parantezë për zbatueshmërinë e nenit 329/3/c të Kodit të Procedurës Penale si dhe për instrumentin e “kërkesës për gjykim”, por nuk referon dispozitat ligjore të zbatueshme që parashikon Kodi i Procedurës Penale.

²³ Referuar faqes zyrtare të internetit të Gjykatës së Apelit Vlorë rezulton se gjyqtari *** ***, ka filluar të ushtrojë detyrën e gjyqtarit pranë kësaj gjykate më datë **.10.2020.

²⁴ Referohuni f. 19, 20 dhe 21 të aktit.

²⁵ Vërejmë se nuk referohen ekstremitetet e Urdhërit të ri të Prokurorit të Përgjithshëm të vitit 2020 për të verifikuar rregullimet e reja të ndryshme nga udhëzimi i vitit 2019 si dhe referenca për praktikën e referuar.

19.6 Komisioneri Publik, sa më lart referuar, vlerëson se del e nevojshme të hetohet, në drejtim të verifikimit, nëse veprimet e ndërmarra nga subjekti i rivlerësimit në këtë çështje penale, të filluar në muajin dhjetor 2015, të përfunduar me vendimin e formës së prerë, datë 22.8.2021, janë në përmbushje të standardeve të nenit 73 pika 2 të ligjit 96/2016, i ndryshuar, përsa i përket aftësisë për të hetuar, për të marrë urdhra dhe vendime dhe kohëzgjatjes.

20. Procedimi penal nr. */2015²⁶** (çështje e transferuar nga Komisioni pranë ILD-së).

20.1 Komisioni ka ardhur në dijeni të këtij procedimi penal të ndjekur nga subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet denoncimit të paraqitura nga shtetasi *** ***, dhe pasi ka vlerësuar aktet shoqëruese si dhe aktet e përcjella nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, ka arsytuar²⁷, se lidhur me çështjen duket se: (i) Nuk janë kryer veprimet hetimore brenda kohës së vendosur nga gjykatat për kryerjen e hetimeve shtesë dhe (ii) Nuk janë kryer hetime të plota dhe shteruese, referuar vendimeve të gjykatave, të cilat kanë urdhëruar në mënyrë të përsëritur kryerjen e veprimeve hetimore. Për pasojë, i ka kaluar barrën e provës subjektit të rivlerësimit.

20.2 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e paraqitura ndaj rezultateve të hetimit administrativ²⁸, ndër të tjera, ka shpjeguar se: *“Në konstatimet tuaja ju shpreheni se janë zvarritur hetimet paraprake. Në cilësinë e prokurores së çështjes ju informoj se në çështjen në fjalë në thelb është duke u operuar vetëm me funksionin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor (që nuk ka afat të përcaktuar) pasi ushtrimi i ndjekjes penale nuk mund të bëhet për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale të parashikuar nga neni 66 i Kodit Penal. Personalisht nuk më rezulton ndonjë e dhënë për të ndryshuar qendrim, pra “nuk mund të pretendohet se je mashtruar me pasojë lejimin e institucioneve të zbatojnë aktet administrative të nxjerra dhe të pakundërshtuara gjyqësisht sikurse është ekzekutimi i vendimeve për prishje objektit në vitin 2005. Çështja në fjalë është paraqitur me kërkesën për pushim në gjykatë, ku dhe vijon të jetë”*.

20.3 Komisioni, në përfundim për sa më sipër, ndër të tjera, ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit kishte treguar disa mangësi në kryerjen e veprimeve hetimore të materialit të kallëzuar të shtetasit *** ***, për sa gjykatat e kanë kthyer çështjen disa herë për rihetim, duke mos vlerësuar të drejtë pushimin e hetimeve. Më tej, Komisioni vlerëson se sipas akteve të administruara, kjo çështje është ende në shqyrtim, duke i dhënë rëndësi faktit se vlerësimi i aftësisë nuk shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim, referuar pikës 2²⁹, të nenit E, të Aneksit të Kushtetutës. Për këto shkaqe, Komisioni ka vlerësuar se është në kushtet e pengesës

²⁶ Ky procedim penal mbas vendimit të mosfillimit nga subjekti i rivlerësimit dhe urdhërimit të Gjykatës së Apelit për vijimin e hetimeve, është regjistruar me numrin ***/2017.

²⁷ Referuar f. 20-21, të vendimit, pika 1.1 “Konstatime të Komisionit lidhur me çështjen.

²⁸ Referuar rezultateve të hetimit administrativ dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimi, dërguar me emailin e datës 29.4.2022, rezulton se Komisioni i ka kaluar barrë prove dhe subjekti është përgjigjur për këto çështje: (i) Subjekti ka zvarritur përfundimin e hetimeve shtesë përtej periudhës 2-mujore të përcaktuar në Vendimin e Gjykatës së Apelit. Neni 323 i K.Pr.P., afatet e hetimit në kuptimin e ngushtë i lidh me regjistrimin e emrit të personit që i atribuohet vepra penale, ndërkohë, vonesat e konstatuara më lart lidhen me faktin se subjekti ka zvarritur hetimet për periudha të gjata kohore dhe pa arsye ligjore si dhe mosdhënies së zgjidhjes së procedimeve për periudha të gjata kohore dhe pas sugjerimeve dhe orientimeve nga Gjykata e Apelit. Pra, rezultati i hetimit nuk është lidhur ngushtësisht me afatin 3-mujor të parashikuar nga neni 323, por ky afat është marrë si referencë me qëllim vënien në dukje të vonesave nga subjekti pa shkaqe të arsyeshme, duke sjellë si pasojë zvarritjen e hetimeve. Subjekti ka kryer hetime të paplota edhe pas kthimit nga Gjykata e Apelit lidhur me vazhdimin e hetimeve të procedimit penal; (ii) Në përfundim, Komisioni konstaton se subjekti, në raste të përsëritura, ka zvarritur për periudha të gjata kohore dhe pa pasur arsye ligjore, hetimet paraprake; (iii) Nga tërësia e veprimeve procedurale konstatohen veprime dhe mosveprime individuale të subjektit të rivlerësimit, të cilat kanë ndikuar në zvarritjen e pajustificuar të gjykimit të çështjes.

²⁹ Vlerësimi i aftësisë nuk shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim...

kushtetuese të vlerësojë rastin, por duke evidentuar se çështja e denoncuesit ka zgjatur 5 vjet, pa gjetur një zgjidhje, në përfundim ka vendosur transferimin e kësaj çështjeje pranë ILD-së.

21. Komisioneri Publik, ndryshe nga përfundimi i arritur nga Komisioni si më sipër, vlerëson se procedimi penal nr. ***/2015, nuk duhet të nxirrej jashtë juridiksionit rivlerësues, pasi në një vlerësim tërësor të çështjes, rasti objekt ankimi, paraqet situata të cilat të marra së bashku, shoqëruar dhe me një hetim të mangët, ndikojnë pozitën e subjektit të rivlerësimit në drejtim të vlerësimit profesional, duke mos justifikuar kështu aplikimin e nenit 59, pika 4 të ligjit nr. 84/2016.

21.1 Në rastin e zbatimit të kësaj dispozite ligjore, aplikuar edhe në transferimin e çështjes tjetër penale me nr. ***/2019 (trajtuar në vijim), Komisioni do duhet të mbante në konsideratë jurisprudencën e Kolegjit për raste të ngjashme, i cili ka vlerësuar në vendimin (JR) nr. 2/2020, se zbatimi i saj (nenit 59/4) ka si kusht që [...] *Komisioni pasi ka bërë një hetim të thelluar, ka vendosur lejimin e subjektit që të vijojë të qëndrojë në sistemin e drejtësisë, por duke evidentuar shkaqe që mund të përbëjnë shkelje, të cilat praktikisht duhet të jenë të lehta, për sa kohë subjekti i rivlerësimit është konfirmuar, dhe nuk cenon sistemin e drejtësisë dhe besimin e publikut. [...]*³⁰

21.2 Komisioneri Publik, nuk pajtohet edhe me vlerësimin tjetër të Komisionit se për rastin e procedimit penal nr. ***/2015, ndodhemi përpara pengesës kushtetuese të parashikuar nga neni E, pika 2, e Aneksit të Kushtetutës. Referuar ecurisë procedurale dhe natyrës së shkeljeve të konstatuara në procedimin penal përkatës, subjekti është shprehur e rishprehur mbi çështjen disa herë, si detyrim nga vendimmarrja e gjykatave përkatëse të cilat kanë konstatuar gjithnjë hetime të pa plota duke vendosur detyra konkrete për hetimin e çështjes, në harkun kohor prej vitit 2015 e deri në korrik të vitit 2021, moment që sikurse provohet, subjekti i rivlerësimit ka ankimuar vendimin gjyqësor me nr. ***, datë **.6.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe çështja pritet për shqyrtim pranë Gjykatë së Apelit Vlorë, për të tretën herë.

21.3 Në lidhje me kuptimin e drejtë të pengesës ligjore të parashikuar nga neni E, i Aneksit të Kushtetutës, Kolegji në vendimin (JR) nr. 28/2020, ka arsyetuar se [...]. *Në një qëndrim të konsoliduar tashmë (shih vendimet e Kolegjit nr. 7/2019, datë 05.04.2019; nr. 16/2020 (JR), datë 13.07.2020), Kolegji ka pranuar se zbatimi i nenit E, paragrafi i 2-të i Aneksit të Kushtetutës, i cili parashikon se: [...] Vlerësimi i aftësisë nuk shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim, do të zbatohet ndaj atyre çështjeve të cilat janë në shqyrtim në kohën e kryerjes së procesit të rivlerësimit prej vetë magjistratit që po i nënshtrohet procesit të rivlerësimit dhe jo nga organe të tjera më të larta apo alternative, siç është rasti në fjalë. Në këto rrethana, çështja gjyqësore e analizuar ka përfunduar shqyrtimin e saj prej subjektit të rivlerësimit, i cili është shprehur me vendimin përfundimtar për zgjidhjen e saj, dhe qenia e saj e varur para*

³⁰ Më tej, në të njëjtin vendim, Kolegji arsyeton: [...] *Si rrjedhojë e kësaj logjike, praktikata të cilat transferohen për inspektim në organet kompetente, në parim duhet të përmbajnë shkelje joserioze, pa pasoja të rënda procedurale për palët, brenda afateve të parashikuara në nenin 117 të ligjit nr. 96/2016, si rasti i procedimit {***}, pasi në rast të kundërt do të kemi gjendje të përsëritur të gabimeve në gjykim, çka dëshmon për praninë e mangësive profesionale të evidentuara të paktën në dy procedimet penale të fundit të shqyrtuara në këtë vendim dhe, që siç parashikohet në nenin 44, germa “c” e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit mund të vlerësohet “i papërshtatshëm” nga vlerësimi i aftësive profesionale, pasi në përputhje me interpretimin pajtues të vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, konstatohen raste të gjykimeve me gabime thelbësore, serioze dhe të përsëritura. Këto gabime nga Komisioni duhen vlerësuar sipas parashikimeve të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, në funksion të nenit 4, pika 2 e të njëjtit ligj dhe, sipas nenit 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji orienton Komisionin për zgjidhjen e çështjeve të ngjashme [...]*

Gjykatës së Lartë, në pritje të një gjykimi atje, nuk e bën këtë çështje “nën shqyrtim”, në kuptim të parashikimit të nenit E, paragrafi i 2-të i Aneksit të Kushtetutës, për pasojë Komisioni ka qenë i legjitimuar të analizojë e vlerësojë edhe këtë çështje në kuadër të vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit [...]

21.4 Për sa më sipër, në përputhje me jurispridencën e deritanishme, rezulton se parashikimi i nenit E të Aneksit të Kushtetutës nuk lidhet me statusin në tërësi të çështjes, por me ato çështje të cilat janë në proces shqyrtimi nga subjekti gjatë procesit të rivlerësimit, dhe çështja në fjalë rezulton se nuk është në hetim nga subjekti i rivlerësimit.

21.5 Duke ju rikthyer ecurisë së procedimit penal nr. ***/2015, në vlerësim të akteve të administruara, Komisioneri Publik konstaton si vijon:

- Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë, më datë **.2.2015, ka regjistruar procedimin penal nr. ***, mbi bazën e kallëzimit penal të shtetasit *** ***, i cili ka referuar për dy vepra penale, atë të “Falsifikimit të dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i K. Penal dhe të “Mashttrimit”, parashikuar nga neni 143 i K. Penal.

- Në datë **.3.2015, bazuar në nenin 290, germa “ç” dhe nenin 291, të K. Pr. Penale, subjekti i rivlerësimit në cilësinë e prokurores së çështjes, me vendimin nr. *** akti, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal.

- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, pasi ka marrë në shqyrtim ankesën e kallëzuesit *** ***, për kundërshtimin e vendimit të mosfillimit të procedimit penal, me vendimin nr. ***, datë **.11.2015, ka vendosur rrëzimin e ankimit.

- Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. ***, datë **. 6.2017 (vendim, i cili nuk gjendet i administruar në dosje të Komisioni, por referohet nga një vendim tjetër gjyqësor të administruar³¹), ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. ***/2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, duke shfuqizuar vendimin e mosfillimit të procedimit penal nr. ***/2015, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

- Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë, bazuar në vendimin e mësipërm, më datë **.10.2017 ka vendosur regjistrimin e procedimit penal nr. *** të vitit 2017, për veprën penale të “Mashttrimit”, parashikuar nga neni 143 i K. Penal (akti i regjistrimit të këtij procedimi penal nuk është administruar, por referohet nga një vendim gjyqësor).

- Në datë **.12.2018, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar para gjyqtarit të seancës paraprake, pushimin e procedimit penal nr. ***/2017 (akt i cili nuk është i administruar). Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. *** Akti, të datës **.2.2019, pasi ka vlerësuar, ndër të tjera, se nga hetimet e procedimit penale nr. ***/2017, nga ana e organit të Prokurorisë nuk janë përmbushur të gjitha detyrat e lëna nga Gjykata e Apelit me vendimin nr. ***/2017, si dhe, pasi cakton disa detyra në funksion të hetimit të mëtejshëm të çështjes (administrim aktesh dhe kryerjen e veprimit hetimor të ballafaqimit), ka vendosur rrëzimin e kërkesës për pushimin e procedimit penal nr. ***/2017, kryerjen e veprimeve hetimore të përshkuara në pjesën arsyetuese të vendimit, brenda afatit dy mujor nga marrja formë e prerë e këtij vendimi.

- Subjekti i rivlerësimit në datë **.2.2019, ka paraqitur ankim kundër vendimit nr. *** Akti, të datës **.2.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Mbi bazën e këtij ankimi,

³¹ Referohet në vendimin nr. ***akti, datë **.2.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, gjyqtar z. *** ***

Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. ***, datë **.3.2019, pasi vlerëson se organi i hetimit nuk ka kryer veprime hetimore të mjaftueshme që janë thelbësore për të vendosur procedimin e mëtejshëm të çështjes, ka vendosur lënien në fuqi të vendimin të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë me nr. *** (nr. *** Akti), të datës **.2.2019.

- Pasi i janë kthyer aktet dhe ka rifilluar hetimin penal, subjekti i rivlerësimit i është drejtuar sërish Gjykatës me kërkesën për pushimin e procedim penal nr. ***/2019 (akt i cili nuk gjendet i administruar në dosjen e Komisionit, por referohet në vendimin nr.**, datë **.6.2021 të gjykatës).

- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, pasi konstaton mungesë hetimesh duke i vlerësuar të drejta kërkesat e paraqitura nga kallëzuesi *** ***, referuar edhe subjektit të rivlerësimit nëpërmjet Memos nr. *** prot., datë **.2.2020, për marrje aktesh dhe kryerje të veprimeve hetimore, me vendimin nr. **, datë **.6.2021, ka vendosur mospranimin e kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë për pushimin e procedimit penal nr. ***/2017, duke urdhëruar vazhdimin e hetimeve, detajuar në pjesën arsyetuese të këtij vendimi.

- Subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurores së çështjes, ka ankimuar vendimin e mësipërm të gjykatës, në datë **.7.2021. Aktualisht nuk dihet statusi i kësaj çështjeje.

21.6 Në analizë të konstatimeve të mësipërme, në raport me gjetjet e Komisionit, të cilat i janë kaluar barrë prove subjektit të rivlerësimit dhe përfundimeve të arritura prej tij (Komisionit), në mungesë të një hetimi të plotë dhe akteve përkatëse - cituar më sipër, Komisioneri Publik, çmon se procedimi penal nr. ***/2015, duhet rivlerësuar në kuadër të juridiksionit kontrollues të Kolegjit, pasi ky i fundit të riçelë hetimin administrativ dhe të administrojë të gjitha aktet e nevojshme të këtij procedimi penal. Kjo do të mundësonte që, për qëllim të procesit të rivlerësimit, shqyrtimi gjyqësor i rastit, në vështrim të nenit E, të Aneksit të Kushtetutës, ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 71 dhe 73, të ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar, do të evidentonte veprimet dhe mos veprimet e subjektit të rivlerësimit që kanë ndikuar në mungesën e hetimeve, vonesat e tejzgjatura kohore dhe përfundimit të hetimit penal, si dhe mos respektimin në kohë të detyrave të lëna nga gjykata. Këto rrethana të konstatuara disa herë edhe nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm penal, vlerësojmë se duhen parë si mangësi lidhur me aftësinë profesionale dhe ato organizative të subjekti të rivlerësimit.

22. Procedimi penal nr. */2019³² (çështje e transferuar nga Komisioni pranë ILD-së).**

22.1 Komisioni ka ardhur në dijeni të këtij procedimi penal të ndjekur nga subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet denoncimit të paraqitura nga shtetasi *** ***, (përfaqësuesi ligjor i shtetasit *** ***) dhe pasi ka vlerësuar aktet e fashikullit penal përcjellë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë³³, ka vlerësuar: (i) Edhe pse çështja është në gjykim e sipër konstatohen veprime dhe mosveprime individuale të subjektit të rivlerësimit, të cilat kanë ndikuar në zvarritjen e pajustificuar të gjykimit të çështjes; (ii) Subjekti, edhe pas urdhërimeve nga Gjykata e Apelit Vlorë dhe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, duket se nuk i ka dhënë zgjidhje procedimit për një periudhë të gjatë kohore, ka vonuar nxjerrjen e rezultateve të hetimit

³² Ky procedim penal mbas vendimit të mosfillimit nga subjekti i rivlerësimit dhe urdhërimit të Gjykatës së Apelit për regjistrimin e procedimit penal për veprën penale të "Falsifikimit", parashikuar nga neni 186 i K. Penal, është regjistruar me numrin ***/2020.

³³ Përcjellë pranë Komisionit me shkresën me nr. ***prot., datë **.12.2021.

në mënyrë të pamotivuar, pasi nuk ka kryer menjëherë verifikime të mundshme kur ishte e nevojshme. Për pasojë, Komisioni i ka kaluar barrën e provës subjektivitetit të rivlerësimit.

22.2 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e paraqitura ndaj rezultateve të hetimit administrativ, ndër të tjera, ka pretenduar se: *“Në rastin në fjalë, ndryshe nga sa ju konstatoni nuk bie në sy mbajtja e çështjes në proces verifikimi për periudhën **.07.2019 – **.07.2019 dhe pas prishjes së vendimmarrjes së mosfillimit në proces hetimi për periudhën **.05.2020 – **.11.2020. Në rastin në fjalë, ajo që është për t’ u diskutuar është qendrimi i mbajtur nga prokurori i apelit në kushtet kur një gjyqtar e ka konsideruar të drejtë vendimmarrjen e prokurorit të çështjes, ndërsa prokurori i apelit kërkon prishjen edhe të vendimit të prokurorit për mosfillim edhe të vendimit gjyqësor përkatës që e ka konsideruar të drejtë këtë vendimmarrje”*³⁴.

22.3 Komisioni, në përfundim për sa më sipër, ndër të tjera, ka vlerësuar, se nisur nga fakti që kjo çështje rezultoi të ishte ende në shqyrtim gjyqësor, në zbatim të pengesës ligjore të parashikuar në pikën 2, neni E, i Aneksit të Kushtetutës, ku parashikohet se vlerësimi i aftësisë nuk shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim, si dhe orientimeve të Kolegjit (vendimi nr. 33/2021), çmon se kjo çështje nuk mund të vlerësohet nga Komisioni. Pretendimet e ngritura nga denoncuesi në lidhje me veprimtarinë e subjektivitetit të rivlerësimit për këtë denoncim janë për t’ u vlerësuar më tej nga organi kompetent i ILD-së.

23. Komisioneri Publik, sikurse ka mbajtur qendrim në pikën 21-21.4 të këtij ankimi, edhe në këtë rast, ndryshe nga përfundimi i arritur nga Komisioni, vlerëson se procedimi penal nr. ***/2019, nuk duhet të nxirrej jashtë juridiksionit rivlerësues, pasi në një vlerësim tërësor të çështjes, rasti objekt ankimi, paraqet situata, të cilat të marra së bashku, shoqëruar dhe me një hetim të mangët, ndikojnë pozitën e subjektivitetit të rivlerësimit në drejtim të vlerësimit profesional, duke mos justifikuar kështu aplikimin e nenit 59, pika 4 të ligjit nr. 84/2016.

23.1 Për të mos rënë në përsëritje, lidhur me trajtimin ligjor të “çështjes në shqyrtim”, parashikuar nga neni E, i Aneksit të Kushtetutës, dhe rastet kur ajo përbën pengesë ligjore në vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, trajtuar më sipër, Komisioneri Publik vlerëson se referenca e Komisionit në vendimin (JR) nr. 33/2021, të Kolegjit nuk është relevante. Referuar arsytimit të këtij vendimi (prg. 76, 79-80 dhe 84³⁵), faktet dhe faza procedurale e marrë në analizë nuk janë të njëjta me faktet dhe rrethanat të vërejtura në rastin objekt ankimi, ku kthimi i akteve subjektivitetit të rivlerësimit dhe të metat e procedimeve penale të ndjekura prej tij janë gjetur dhe verifikuar deri në dy herë nga Gjykata e Apelit. Fokusi i vlerësimit për nga veçantia dhe mangësitë që paraqet rasti, çmojmë se është i ndryshëm.

23.2 Duke ju rikthyer vlerësimit të efektivitetit të ushtrimit të ndjekjes penale dhe administrimit të procedimit penal nr. ***/2019, në analizë të akteve të administruara, Komisioneri Publik konstaton si vijon:

³⁴ Subjekti i rivlerësimit ka bashkëlidhur edhe nëntë akte.

³⁵ Vlerësimi i Kolegjit për këtë rast, nis me faktin se: [...] *Në analizë të pretendimeve të subjektivitetit të rivlerësimit në këtë shkak ankimi, në raport me situatën faktike si më sipër dhe konkluzionet e Komisionit, trupi gjyqësor vëren se subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, ka informuar Komisionin se kërkesa për pushimin e kësaj çështjeje ishte duke u shqyrtuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe seanca gjyqësore e radhës ishte caktuar më datë **.10.2019. [...]*

- Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë, më datë **.7.2019, ka regjistruar procedimin penal nr. ***, mbi bazën e kallëzimit të shtetasi *** ***,³⁶, i cili ka referuar se ndaj shtetases *** ***, duhet filluar ndjekja penale për dy vepra, atë të “Falsifikimit të dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i K. Penal dhe “Pastrim i produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i K. Penal.

- Në datë **.7.2019, subjekti i rivlerësimit në cilësinë e prokurores së çështjes, pasi ka vlerësuar se ndjekja penale nuk mund të fillojë, pasi fakti i parashtruar nuk përbën elementët e figurës së ndonjë vepre penale, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal.

- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, pasi ka marrë në shqyrtim ankesën e kallëzuesit *** ***, për kundërshtimin e vendimit të mosfillimit të procedimit penal, me vendimin nr. ***, datë **.10.2019, ka vendosur rrëzimin e ankimit.

- Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. ***, datë **.12.2019, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. ***/2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, pasi ka konstatuar mungesë të hetimit penal nga ana e organit të Prokurorisë. Gjykata e Apelit Vlorë ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal për veprën “Falsifikim i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i K. Penal, duke lënë dhe detyra konkrete për hetimin e rastit.

- Mbas pesë muajsh, subjekti i rivlerësimit në cilësinë e prokurores së çështjes, bazuar në vendimin e mësipërm, në datë **.5.2020, ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal nr.*** të vitit 2020, për veprën penale të “Falsifikimit të dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i K. Penal.

- Në datë **.11.2020, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar para gjyqtarit të seancës paraprake, pushimin e procedimit penal nr. ***/2020.

- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. ***, të datës **.1.2021, pasi ka vlerësuar, ndër të tjera, se detyrat e lëna nga Gjykata e Apelit me vendimin nr. ***/2019, nuk janë kryer plotësisht në funksion të hetimit penal nr. 707/2020, ka vendosur kthimin e akteve të çështjes nr. ***/2020, duke urdhëruar kryerjen e aktit të ekspertimit brenda afatit dy mujor.

- Subjekti i rivlerësimit ka ushtruar ankim ndaj vendimit të mësipërm të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

- Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. ***, datë **.3.2021, pasi vlerëson se organi i Prokurorisë nuk ka zbatuar gjithë detyrat e lëna në vendimin nr. ***/2019 të Gjykatës së Apelit Vlorë, ka vendosur lënien në fuqi të vendimin të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë me nr. ***, datë **.1.2019.

- Aktualisht, referuar sqarimeve të dhëna ndaj rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit sqaron se fashikulli hetimor i kësaj çështje është paraqitur në datë **.3.2022, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, ndërkohë që vendimi gjyqësor me shënimet përkatëse nga gjykata ishte sjellë më parë. Pasi fashikulli ka ardhur në Prokurori është vendosur rifillimi i hetimit paraprak, më datë **.3.2022.

- Nga aktet e administruara, rezulton se vetëm në datën **.3.2022, pra gati 1 vit më pas nga dhënia e vendimit, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë me shkresën me nr. ***prot., (***) (***), i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë me kërkesë për dorëzim fashikulli dhe vendimin përkatës.

³⁶ Të dhëna të marra nga përmbajtja e vendimit nr. ***, datë **.10.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

23.3 Në analizë të konstatimeve të mësipërme, në raport me gjetjet e Komisionit të cilat i janë kaluar barrë prove subjektit të rivlerësimit dhe përfundimeve të arritura prej tij (Komisionit), në mungesë të një informacioni të saktë, nëse janë plotësuar nga ana e subjektit të rivlerësimit detyrat e lëna nga gjykatat, Komisioneri Publik, çmon se gjetjet mbi procedimin penal nr. ***/2019 (***/2020), duhen rivlerësuar në kuadër të juridiksionit kontrollues të Kolegjit. Në gjendjen që janë aktet, më së paku, rrethanat tregojnë për një qëndrim të subjektit, të cilat ndikojnë në vlerësimin e indikatorëve matës të kriterit të aftësive profesionale, referuar ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar apo dhe në një vlerësim të përgjithshëm sipas nenit 4/2 të ligjit nr. 84/2016. Në kushtet që vendimi nr. ***/2019 i Gjykatës së Apelit Vlorë, nuk rezulton të jetë ndryshuar nga Gjykata e Lartë, detyrat dhe orientimet e lëna në të kanë qenë detyruese për zbatim nga organi procedues, në këtë rast, nga subjekti i rivlerësimit. Këto detyra rezultojnë të pa përmbushura edhe sipas vendimit nr. **, datë **.3.2021, të Gjykatës së Apelit Vlorë. Mos respektimi i autoritetit gjyqësor nga subjekti i rivlerësimit duket se ka sjellë zvarritje të panevojshme të hetimit të çështjes, në cenim ndaj të drejtave dhe interesat e qytetarit kallëzues.

24. Komisioni ka konstatuar të njëjta problematika si më sipër, afate të tejkgjatura kohore, mos përmbushje të detyrave të lëna nga gjykata në funksion të hetimit penal, edhe në rastin e një prej ankesave të administruara në ILD ndaj subjektit të rivlerësimit, konkretisht për rastin e ankesës së shtetasit *** ***, që lidhet me procedimin penal nr. ***, të vitit 2015, duke kërkuar shpjegime dhe prova nga subjekti në pyetsorin nr. 2, dhe rezultatet e hetimit administrativ.

24.1 Komisioni me shkresën me nr. *** prot., datë **.10.2021, i është drejtuar ILD-së për informacion mbi trajtimin e ankesave ndaj subjektit të rivlerësimiti znj. Alvora. ILD-ja me shkresën nr. ***/** datë **.11.2021, ka informuar Komisionin, ndër të tjera, se për rastin e ankesës së shtetasit *** ***, (***) regjistruar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. *** prot., datë **.3.2020, pas shqyrtimit fillestar të ankesës, është marrë vendimi nr. ***/** prot., datë **.4.2021 *“Për verifikimin pas shqyrtimit fillestar të ankesave...³⁷”*.

24.2 Nga aktet e administruara, shpjegimet dhe provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit, rezulton se për rastin e ankesës së shtetasit *** ***, procedimi penal nr. ***, të vitit 2015, nga momenti i regjistrimit të kallëzimit për veprën penale të “Falsifikimit të dokumenteve” parashikuar nga neni 186 i K. Penal, është ndjekur nga një tjetër prokuror, i cili me vendimin e datës **.7.2016, ka vendosur pushimin e pjesshëm të hetimeve, pasi nuk provohet kryerja e kësaj vepre penale. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, mbi bazën e ankesës së shtetasit *** ***, dhe *** ***, me vendimin nr. ***, datë **.12.2017, ka vendosur rrëzimin e ankimit.

24.3 Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. ***, datë **.6.2018, ka vendosur ndryshimin e vendimin nr. **/2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, duke shfuqizuar vendimin për pushimin e pjesshëm të hetimeve të procedimit penal dhe urdhërimin për vazhdimin e tyre, sipas detyrave të lëna në pjesën arsyetuese. Mbi bazën e këtij vendimi, çështja e rikthyer për vazhdimin e hetimeve është rishortuar, duke u zëvendësuar prokurori i çështjes z. *** *** me subjektin e rivlerësimit, referuar shortit të datës **.9.2018.

³⁷ Referuar përmbajtjes së këtij vendimi, është vlerësuar se ka vend për verifikim të pretendimeve të ankuesit për zvarritje të hetimeve paraprake dhe mosdhënie informacioni.

24.4 Për sa më sipër, referuar rezultateve të hetimit administrativ, Komisioni, ndër të tjera, ka konstatuar se nga data **.10.2018, moment në të cilin subjekti i rivlerësimit ka vendosur rifillimin e hetimeve për procedimin penal nr. ***/2015, përveç pyetjes së shtetasit *** ** në cilësinë e personit që ka dijani për veprën penale nuk rezultojnë të jenë kryer hetime të tjera dhe as të ketë përfunduar deri në datën **.2.2021. Shpjegimet e subjektit në lidhje me vonesat nuk janë bindëse, pasi është detyrë e prokurorit që të marrë të gjitha masat për kryerjen e veprimeve hetimore në kohë, sidomos pas detyrave të përcaktuara në vendimin e Gjykatës së Apelit për përfundimin e hetimeve shtesë, në vendimin nr. ***, datë **.6.2018.

24.5 Komisioni, pas shpjegimeve të dhëna nga subjekti, ndër të tjera, ka arritur në përfundimin³⁸, se mangësitë e konstatuara janë të pashoqëruara me mangësi të tjera dhe në raport me ngarkesën e çështjeve të hetuara nuk janë të mjaftueshme për t' i çmuar si cilësi të papranueshme në punë, gjykim të dobët apo një mënyrë pune e papajtueshme me funksionin e saj. Në këtë drejtim, nuk rezultuan indicie apo elementë në çështje të tjera për të ngritur dyshime se subjekti ka një mënyrë/model pune të papajtueshëm me pozicionin e saj dhe as shkelje të respektimit të të drejtave të palëve.

25. Komisioneri Publik, në analizë të fakteve përshkruar si më sipër, vlerëson se përfundimi i arritur nga Komisioni është rrjedhojë e një hetimi të mangët dhe i pa mbështetur në prova. Nga aktet e administruara dhe përgjigjet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit nuk rezultojnë të jenë dhënë përgjigje bindëse mbi arsyet, veprimet dhe mos veprimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me ecurinë e procedimit penal dhe përmbushjes së detyrave të lëna nga Gjykata e Apelit Vlorë, në vendimin nr. ***, datë **.6.2018. Nga momenti i rifillimit të hetimit penal, mbeten të paqarta veprimet procedurale të ndërmarra nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe nevoja e tyre e shtrirë në një kohë relativisht të gjatë, prej tetorit 2018 deri në datë **.2.2022, moment në të cilin subjekti i rivlerësimit shpjegon se ka përpiluar kërkesën për pushimin e çështjes dhe se tashmë ajo ndodhet për shqyrtim në gjykatë³⁹. Nga aktet nuk dihet ecuria e shqyrtimit të kësaj kërkesë.

25.1 Komisioneri Publik, çmon se hetimi dhe vlerësimi i filluar nga ana e ILD-së, dhe vendimmarrja eventuale e këtij organi kushtetues, marrë në zbatim të një kuadri tjetër ligjor, nuk mund të ndikojë apo zëvendësojë juridiksionin rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, për qëllim të nenit 179/b të Kushtetutës dhe nenit 59 të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, vlerësojmë se gjetjet në rastin e procedimit penal nr. ***/2015, duhet të rivlerësohen nga Kolegji, pasi ky i fundit të riçelë hetimin administrativ dhe të administrojë të gjitha aktet e nevojshme të këtij procedimi penal.

26. Duke përfunduar për sa më sipër, bazuar në indikatorët vlerësues të parashikuar nga nenet 71-73 të ligji nr. 96/2016, i ndryshuar dhe ligjit të posaçëm nr. 84/2016, Komisioneri Publik e vlerëson të nevojshme riçeljen e hetimit administrativ nga ana e Kolegjit dhe rivlerësimin e rastit nën optikën nëse veprimet dhe mos veprimet e subjektit të rivlerësimit, përbëjnë mangësi profesionale apo model pune të tillë, që sjell vonesa të tepruara dhe mungesë efektiviteti në procedime jo komplekse. Sikurse u konstatua, në disa raste, megjithëse ka pasur

³⁸ Në arsyetimin e vendimit, rasti është trajtuar së bashku edhe me raste të tjera, në rubrikën "Të dhënat arkivore (ankesat dhe masat disiplinore-vlerësimet)", në f. 17-18, të vendimit.

³⁹ Referuar përgjigjeve të dhëna nga subjekti në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ, dërguar me emailin e datës 28.4.2022.

si detyrim respektimin e urdhërimeve të qarta dhe logjike nga gjykatat, ato sërish nuk janë realizuar në kohë duke sjellë edhe cenim të të drejtave të palëve të përfshira apo që kishin interes mbi ecurinë dhe mbarvajtjen e hetimit penal dhe përfundimeve të pritshme prej tij, brenda afateve të arsyeshme, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të KEDNj-së.

IV. Kërkimi i ankimit

27. Nisur nga parashikimi i nenit 179/b/5 të Kushtetutës, Aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se hetimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, referuar gjendjes së fakteve dhe provave, nuk ka qenë i plotë me qëllim arritjen e bindjes se subjekti i rivlerësimit arrin nivel të besueshën për konfirmimin e tij në detyrë, në kuptim të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

28. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar, në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin ose shkarkimin e subjektit, ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara për këtë qëllim;

29. Bazuar në kërkesat e neneve Ç, D, Dh, E dhe F, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, të ligjit nr. 84/2016;

Kërkojmë që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit dhe, në zbatim të nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, të vendosë në mënyrë alternative:

- Ndryshimin e vendimit nr. 538, datë 7.6.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, ose
- Lënien në fuqi të këtij vendimi.

KOMISIONERI PUBLIK

Irena NINO